

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Makine me Kosh Bashkia Kolonjë ,viti 2024.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

34100000-8 - Automjete, 34140000-0 - Automjete të rënda, 34144000-8 - Automjete për qëllime të veçanta, 34144400-2 - Automjete për mirëmbajtjen rrugore, 34144700-5 - Automjete shërbimesh,

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,000,000 (Katërmilion) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”,i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kolonjë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori/et ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021-2022-2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e madhe se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet**.

Ç’ka do të thotë që operatorët ekonomik do të paraqesim dëshmi **për furnizime të mëparshme të ngjashme** në një vlerë **deri në 40%**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në **nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”**, ku parashikohet se: *“Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”*.

si dhe bazuar në nenin **43, pika 2/c, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, parashikohet se:

“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nënkufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e madhe se 40% e vlerës së fondit limit** dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Autoriteti Kontraktor në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2 Operatori/et ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021-2022-2023**, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori/et ekonomikë ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet **për vitin 2023** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore **dhe për vitin e fundit 2024 (këstet e maturuara)**.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimevetë nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në një vlerë jo më të madhe se 20 %** të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe rekomandimit Nr.1797/1 Prot.datë.10.03.2022 të agjensisë së prokurimit publik.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë **në një vlerë jo më të madhe se 20 %** të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vërtetuar ekspriencen e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses.

2.3.2 Operatori/et ekonomike duhet të ketë në stafin e tij të paktën **1(një)** inxhinier mekanik.

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma
- Dëshmi të aftësisë profesionale si Përgjegjës Teknik
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim:*Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.Konkretisht: operatori/et ekonomike duhet të kenë të paktën **1(një) inxhinier mekanik**, është vendosur për të garantuar plotësimin e detyrimeve të kontratës.*

2.3.3 Operatori/et ekonomike duhet të paraqes/in Certifikata ISO ose ekuivalente dhe duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit:

- ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Autoriteti kontraktor do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN; SSH/ISO mbi konformitetin e standardit europian apo atij ISO, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

VO: Nëse certifikatat nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .

Argumentim:*Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.3.4 Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të garancisë, operatorit ekonomik duhet të disponojë servis në Pronësi ose Kontratë huapërdorje ose Kontratë qiraje servisi për shërbimin riparimit ose menyra të parashikuara nga legjislacioni në fuqi të cilat detyrimisht duhen të jenë të pajisur me dokumentacionin si më poshtë :

a. Liçensë nga Qendra Kombëtare e Liçensimit VII.3.B.1 Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

b. Dokumentacion që vërteton pronësinë e servisit :

- Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose kontrata e dhurimit; ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacion që vërteton huapërdorjen e servisit :

- Kontratë huapërdorje.

Dokumentacion që vërteton marrjen me qirav e servisit :

- Kontratë qiraje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe udhëzimit Nr.1546, datë 29.3.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”. *Liçenca e mësipërme është e lëshuar nga QKL, lidhet ngushtë me objektin e prokurimit, dhe kërkimi i saj që të zotërohen nga OE pjesëmarrës në procedurë garanton kualifikime dhe cilësi. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.*

Kërkesa që OE duhet të deklarojë se disponon në Pronësi ose Kontratë huapërdorje ose Kontratë qiraje servis përgjatë gjithë periudhës së garancisë, është hartuar në vijim të kërkesës së mësipërme për paraqitjen e garancisë së automjetit. Nëpërmjet kësaj kërkesë AK do të sigurohet që shërbimet e përfshira në garancinë e deklaruar nga OE do të kryhen në një operator të specializuar për këtë aktivitet.

2.3.5 Për mjetin e patarguar të paraqiten :

- Dokumentin e zhdoganimit (DAV) të lëshuar nga Dogana Shqipëtare (origjinal).
- Dokumentin ose dokumentat e fitimit të pronësisë në njëren nga format që parashikon Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.
- Dokumentin shoqërues, prejardhës, me treguesit teknike të mjetit, në origjinal.
- Kontratë sigurimi të detyrueshëm (Polica e Sigurimit TPL).
- Mjeti të shoqërohet me foto.

Ose,

Për mjetin e targuar të paraqiten:

- Leje Qarkullimi.
- Police sigurimi, e vlefshme për vitin 2024-2025.
- Certifikata e kontrollit teknik , e vlefshme për vitin 2024-2025.
- Certifikatën e kolaudit (inspektimit) të koshit .
- Dokumentin shoqërues, prejardhës, me treguesit teknike të mjetit, në origjinal.
- Mjeti të shoqërohet me foto.

*Në rast se dokumentet e mësipërme nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

2.3.6 Operatori/et ekonomike duhet të paraqes/in **Fletë Garancinë** e mjetit **Autokosh**, për një periudhë deri në **1(një) vit** pa limit **km** që do të mbulojë mbi defektet e mundshme në motor dhe kambio. Shitësi do të përgjigjet për riparimin e defekteve jo më vonë se tre ditë nga njoftimi. Defektet e shkaktuara nga drejtuesi i mjetit nuk janë përgjegjësi e shitësit. Përcaktimi i shkakut në rast defekti do të identifikohet nga një ekspert i cili do të zgjidhet me miratimin e palëve. Operatori/et ekonomike duhet të deklarojë/në kushtet teknike të garancisë dhe shërbimet e përfshira brënda periudhës së garancisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 32 të Ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, dhe Operatori/et ekonomike duhet të paraqes/in **Fletë Garancinë** e mjetit **Autokosh** për një periudhë deri në **1(një) vit** pa limit **km** që do të mbulojë mbi defektet e mundshme në motor dhe kambio momenti i levrimit të mallit.

2.3.7 Operatori/et ekonomike duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mjetit pranë Autoritetit Kontraktor do ta shoqërojë atë me:

Çertifikatën e pronësisë së mjetit (në emër të AK)

Lejen e qarkullimit të mjetit (në emër të AK)

Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (në emër të AK)

Certifikatën e kolaudit (inspektimit) të koshit (në emër të AK)

Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike (në emër të AK)

Shpenzimet për kalimin në pronësi të autoritetit kontraktor Bashkia Kolonjë të mbulohen nga operatori ekonomik që do të shpallet fitues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, me urdhër me urdhër nr.145 me nr.1268 prot, datë.12.03.2024 nga kryetari i bashkisë kolonjë pjesë përbërëse e strukturës së **Bashkisë Kolonjë**, në përputhje me nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për hartimin e specifikimeve teknike të mjetit **Autokosh**, komisioni është mbështetur dhe ka patur si reference natyrën e punës dhe aktivitetin për të cilin kërkohet të blihet ky mjet. Qëllimi i blerjes së këtij mjeti është që ai do të jetë në shërbim të drejtorisë së shërbimeve për plotësimin e nevojave në zbatimin e detyrave funksionale të sektorëve të ndryshëm. Për këtë arsye, komisioni, iu është referuar informacioneve që gjenden lehtësisht në internet mbi parametrat dhe kapacitetet e mundshme të mjeteve të markave të ndryshme, duke përcaktuar kufij dhe parametra minimalë për sa iu përket përmasave të të mjetit **Autokosh**. Në këtë mënyrë specifikimet teknike janë gjithëpërfshirëse dhe në përputhje të plotë me kërkesat e institucionit në raport me aktivitetin funksional që ky mjet do të kryejë.

Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

Fondi Limit i përlllogaritur për këtë procedurë është hartuar në bazë të prevetivit të përgatitur nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Kolonjë, në bazë të ligjit Nr.162/2020 datë.23.12.2021 “Për Prokurimin Publik”, Neni 34,35,36 Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 285 datë.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 76, i ndryshuar.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **07.05.2024, ora 11:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt, “**Blerje Makine me Kosh Bashkia Kolonjë ,viti 2024**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij proces-verbali:

- Dokumentat e tenderit
- Specifikimet teknike

Njësia e Prokurimit